



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 13. 09. 2011, në orën 11.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Ismet Beqiri, Kymete Bajraktari, Biserka Kostiq.

Mungoi: Duda Balje dhe Justina Pula.

I ftuar: Sami Kurteshi-Avokat i Popullit.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi- OSBE, Ukë Gashi-ZPRK dhe Visar Bivolaku-EUSR.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj- koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi Suazan Novoberdali – kryetare, e cila konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes dhe propozoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 24 dhe 25 gusht 2011;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2010, i ftuar: Sami Kurteshi, Avokat i Popullit i Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i disa kërkesave të qytetarëve;
5. Shqyrtimi dhe plotësimi i planit të punës së Komisionit për gjashtëmuajorin e dytë;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 24 dhe 25 gusht 2011

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 24 dhe 25 gusht 2011.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2010, i ftuar: Sami Kurteshi, Avokat i Popullit i Republikës së Kosovës

Kryetarja- Në pika të shkurtra njoftoi me përmbajtjen e raportit dhe me problemet që ballafaqohet Institucioni i Avokatit të Popullit .

E para ka të bëjë me kërkesën rreth pengesave në përmbushjen e misionit kushtetues të Avokatit të Popullit lidhur me kërkesat për rritjen e numrit të bashkëpunëtorëve, për sigurimin e buxhetit për punën e IAP- së, mospagimi i hapësirës për punë, rrënimin e pavarësisë së IAP-së, të cilat janë prezente, por deri më tani nuk u janë zgjidhur.

Pastaj tha se Raportin e ka analizuar dhe është shumë voluminoz, por shumë çështje janë si probleme të cilat kanë ngelur të pazgjidhura edhe përkundër vullnetit tuaj të mirë për t'i zgjidhur. Problemet e theksuara sipas saj, adresohen në fushën e gjyqësorit që me vite presin lëndët për t'u zgjidhur dhe natyra e tyre se a janë urgjente, nuk kemi dijeni.

Me qene se kame konsideruar se eshte shume akuze e rende qe i tere gjyqesori te perfshihet si i korruptuar me qe kemi shume pak aktgjykime te plotfuqishme, ne baze te qkafit i ka akuzu , ne çka eshte bazu.

Sami Kurteshi-Avokat i popullit, eshte pergjegj se ka te dhena edhe nga Agjensioni Kunder Korrupsioni.

Kryetarja- tha se kam qene kryetare e keshillit te Agjensionit kunder korrupsionit dhe se as Agjensioni nuk i akuzon per korrupsion por vetem si raste te dyshuara ja percjelle prokurorise, prandaj edhe kam konsideru se eshte akuze e rende te perfshihet i gjithe sistemi gjyqsor. Ajo tha se eshte problem i pazgjidhur lendet e grumbulluara dhe permbarimi i aktgjykimeve te formes se prere.

Sa i përket lirisë së mediave përveç garantimit që ofron sistemi juridik në Kosovë në mënyrë të veçantë Kushtetuta e Kosovës, ne raport paraqitet se ka kufizim te lirise se mediave derisa nuk keni te paraqitur asnjë ankese, ne baze te qkafit e keni kete perfundim.

Sami Kurteshi, Avokat i Popullit - Falënderoi anëtarët e Komisionit për ftesën që i është bërë dhe tha se kemi përgatitur raportin e dhjetë vjetor, ndërsa ky raport është rezultat i punës njëvjeçare dhe është i përberë prej tri pjesëve: pjesa e parë është pjesa përmbajtësore, në pjesën e dytë janë aktivitetet, veprimtaria, dhe në pjesën e tretë janë shtojcat që përpiqen për të mbështetur këtë që është thënë.

Sa u përket pyetjeve që m'u bënë nga ana e kryetares, tha se sot nuk e kam marrë kërkesën që kemi bërë, sepse sot jem koncentruar në raportin vjetor, por përafërsisht e kam të qartë se për çka bëhet fjalë.

Më tutje shtoi se në raport janë të paraqitura problemet tona, jemi bazuar në të dhënat tona, ne për problemet që i kemi, i jemi drejtuar vazhdimisht Kuvendit dhe Kuvendi është ne dijeni për këto.

Kymete Bajraktari- Duke u ndërlidhur me raportin e Avokatit të Popullit, pyeti se a është bërë auditimi në këtë institucion, pasi i mungon tabela përkatëse ? Në raport thuhet se keni marrë donacione nga organizata të ndryshme, por nuk paraqiten të hyrat nga donacionet?

Albana Gashi-Bëri pyetje dhe tha se në një raport që na keni dërguar neve si Komision me kërkesa thuhet se Institucioni i Avokatit të Popullit është thënë se ka cenim të pavarësisë së këtij institucioni dhe çka është ky cenim i pavarësisë së këtij institucione se çka është e cenuar, a është Institucioni i Avokatit të Popullit i pavarur në vendimet që i merr?

Biserka Kostic- beri pyetjen se sa ka komunitet serb, ashkali, rom e komunitet tjera në Institucionin e Avokatit të Popullit?

Suzan Novoberdaliu e ngriti çështjen e uzurpimeve të pronave në veri të Mitrovicës dhe bëri pyetje sa i përket uzurpimeve në veri të Mitrovicës, e që është trajtuar si çështje e pazgjidhur dhe vazhdon të jetë në Agjencinë Kosovare të Pronës.

Në raport keni paraqitur se janë regjistruar dyzetyrime të kërkesave, njëzet e gjashtëmijë janë shqyrtuar, ndërsa shtatëmbëdhjetëmijë prej tyre janë zgjidhur, çka do të ndërmerreni lidhur me zgjidhjen e këtij problemi?

Rita Hajzeraj- Tha se kam një pyetje sa u përket kërkesave që i adresohen Institucionit të Avokatit të Popullit, dhe se ky institucion, ato kërkesa i adreson në Komisionin parlamentar pa shkuar ende në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, ne kemi shumë raste të tilla, çka mendoni avokat, a është më mirë që ata të drejtohen më parë në KPMK, në gjykata, në polici, nëse kanë probleme fqinjësore, te Avokati i Popullit, dhe pastaj mund të vijnë ne Komision, nëse nuk gjejnë zgjidhje te këto organe.

Sami Kurteshi, Avokat i Popullit- Në pika të shkurtra u përgjigj në pyetjet që u parashtruan nga ana e anëtarëve të Komisionit dhe tha se në raport jemi munduar që të mos përdorim fjalë të ashpra, por që të jetë një raport fleksibil dhe për të gjitha raste që ju i paraqitët këtu, unë do të bëj përpjekje që të njoftohem me to.

Kryetarja- Falënderoi Avokatin e Popullit për prezantimin dhe përgjigjet që u bënë lidhur me raportin për vitin 2010, pas diskutimit të gjerë dhe konstruktiv, Komisioni në bazë të Rregullores së punës Kuvendit nxori këtë

Përfundim

Komisioni unanimisht e miratoi Raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2010 dhe i rekomandon Kryesisë së Kuvendit që ta procedojë më tutje në një nga seancat radhës të Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Shqyrtimi i disa kërkesave të qytetarëve

Kryetarja- Tha se ne këtë pikë të rendit të ditës kemi për shqyrtim disa kërkesa të qytetarëve, ne për këtë kemi caktuar raportuesit të cilët i shqyrtojnë këto kërkesa, prandaj i ftoi raportuesit që të informojnë Komisionin me përmbajtjen dhe zgjidhjen e tyre

Rita Hajzeraj- Tha se grupi ka shqyrtuar disa kërkesa të qytetarëve të cilët pretendojnë se autoritet ua kanë shkelur të drejtat e tyre . Grupi ka shqyrtuar kërkesën e N. F që ka të bëjë me largim nga, prandaj do të ishte e rrugës që t'i drejtohet inspektoratit policor, në gjykata dhe pasi t'i kalojë procedurat ne këto institucione dhe nëse nuk gjen zgjidhje, atëherë të drejtohet në Komision.

Sa i përket S. S. i cili thekson se ka kërcënim nga fqinji i vet lidhur me pengim të pronës do, të ishte e rrugës që rasti të paraqitet në polici dhe se policia do ta informojë për hapat e mëtejme dhe të ndjek procedurat e parapara, meqë kjo nuk bie në fushëveprimin e Komisionit .

Sa përket kërkesës së sindikatës së NSHB-Suhareka, e cila ka të bëjë me largimin e punëtorëve nga puna në mënyrë të padrejtë, si Komision duhet të presim vendimin e gjykatës dhe më pas të vendosim a është vendim i drejtë apo jo.

Komisioni vendosi që për këtë lëndë t'i rekomandojë këshillit gjyqësor që gjykata ta përshpejtojë shqyrtimin e kësaj lënde dhe lëndëve tjera.

Kërkesa A. F. i cili thotë se është larguar nga puna nga Autoriteti Rregullativ dhe kërkon zbatimin e vendimit të KPMK-së për kthimin në vendin e punës. Komisioni i mbështetë vendimet ne fuqi dhe solidarizohet në zbatimin e vendimit të KPMK-së.

5. Shqyrtimi dhe plotësimi i planit të punës së Komisionit për gjashtëmujorin e dytë

Kryetarja- I kërkoi grupit të punës në përbërje nga: Kymete Bajraktari, Albana Gashi dhe Duda Balje, të hartojë planin e punës edhe për këta muaj, duke përfshirë edhe veten.

6. Të ndryshme

Kryetarja- Tha se në muajin korrik për shkak të aktivitetit të madh të punës, kemi bërë tejkalimin e shpenzimeve për kafe, dhe neve na duhet të bëjmë një vendim të Komisionit lidhur me shumën prej 249,30 euro se për çka është bërë ky tejkalim dhe të arsyetohet. Komisioni vendosi lidhur me këtë t'i informojë organet kompetente të buxhetit dhe sekretarin e Kuvendit.

Komisioni, më 21 shtator do të mbajë dëgjim publik dhe do të bëjë monitorimin e Ligjit për barazi gjinore.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdaliu